

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ARJAN BALLIU

11/18/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 11.11.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Arjan Balliu, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 18.11.2019, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Arjan Balliu, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Xhensila Pine, z. Roland Ilia relator, znj. Valbona Sanxhaktari anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.